



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9222/1 Prot.

Roskovec, më 26.11. 2024

Procesverbal Nr.12

-I mbajtur sot, datë 25.11.2024, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Tetor 2024.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Tetor 2024.
5. Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve, të punës dhe të konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
6. Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.109 datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe të ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2024", të ndryshuar.
7. Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2025.
8. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁵

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, N.Zeka, H.Hajdini, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, S.Bibo Qamili, F.Feleqi, Zh.Metushi, E.Toska.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, E.Kaçeli, P.Toro, A.Hoxha, V.Çepele, A.Pelo.

Prezent nga bashkia: Nënkyetari i bashkisë M.Goga, SP/Shërbimit Social S.Rrapushi, Dr.Ardhurave Vendore O.Goga.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 14 këshilltar. Kryetari – faleminderit të nderuar këshilltar që jeni bërë pjesë e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 25.11.2024, faleminderit përfaqësuesve të administratës së bashkisë, falenderoj gjithashtu organizatorët e një sensibilizimi minimal që mund të bëjmë ne si Këshill Bashkiak, bashkë me grupin iniciator për një ngjarje shumë të rëndë që ka ndodhur në mesin e shoqërisë tonë. Thirrja ime është duke marr shkas se unë po hap këtë mbledhje, është se duhet të jemi në radhë të

parë prindër të kujdeshëm, qytetarë të devotshëm në mënyrë që ngjarje të tilla mos të ndodhin më në gjirin e shoqërisë tonë. Jemi të gjithë nga pak përgjegjës për gjithçka ndodh. Përpala se të miratojmë rendin e ditës, po i japim 5 minuta kohë grupit iniciator për këtë angazhim. Dr. Shërbimit Social Nertila-pëershëndetje të nderuar këshilltar, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpreva mbledhjen tuaj, por duke qënë se sot është 25 Nëntori, dita ndërkombëtare për eleminimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore, Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Roskovec bashkë me kordinatorin vendor kundër dhunës, do tju bëj pjesë e një mesazhi sensibilizues dhe promovues, të gjithë përpjekjeve të institucioneve që janë përgjegjës për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna, por njëkohësisht edhe të gjithë neve si komunitet. Ashtu siç edhe Kryetari i Këshillit e ceku për pjesën e ngjarjes së fundit, ndoshta edukimi fillon së pari nga familjet tona dhe nga mënyra sesi ne edukojmë dhe rrisim djemtë tanë, sepse duke i rritur dhe edukuar ata që të jenë qytetarë të denjë, dhe të duan, të mbështesin shoqet e tyre në klasë, partneret e tyre në jetë, bashkëshortet e tyre, nënrat e tyre, ndoshta mund të arrijmë ta reduktojmë dhe parandalojmë dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Unë ju ftoj në kuadër të kësaj dite të vendosim të gjithë nga një fjongo simbolike që është me ngjyrë portokalli, që simbolizon njëkohësisht dhe fushatën kundër dhunës në familje. Fushata çelet sot dhe përfundon në 10 Dhjetor, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut. Ju falenderoj dhe shpresojmë që të gjithë bashkë të bëjmë më të mirën. Jorgo-duke marr shkas nga kjo, kërkoj masa dhe respekt ndaj gruas dhe fëmijëve, por kërkoj dhe diçka nga bashkia. Duke parë një institucion aty që është pa një masë mbrojtje, duke parë dhe makinat e bashkisë që vijnë në derën e një institucioni shkollor, nuk është e drejtë të merrni dhe një angazhim që këta fëmijë të rriten të sigurt dhe të kenë mbrojtjen siç e kanë të gjithë fëmijët në Republikën e Shqipërisë? Pse keni heshtur ju, duke parë bashkia ballë për ballë kur hyni aty e shikoni një institucion pa një masë sigurie, ca shpjegimi do më jepni? Kryetari- jo vetëm dhuna ndaj grave, por çdo lloj dhune është e tepërt në jetën e gjithsecilit, uroj që të kemi sa më pak episode dhune të çfarë do lloji. Jeni njojur me rendin e ditës të shpërndarë në datën 20.11.2024, ka dikush për të diskutuar diçka në lidhje me rendin e ditës? Nuk ka diskutime.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Tetor 2024.

Sekretarja-në mbledhjen e fundit të Këshillit ju keni miratuar 4 vendime në total dhe nga këto vendime, asnjëra prej tyre nuk ishte vendim normativ të cilin duhej ta dërgonisëm në Prefekturë për verifikim ligjor. Të gjitha vendimet janë zbardhur dhe i janë shpërndarë zyrave pas hyrjes së tyre në fuqi, për zbatime të mëtejshme.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votim procesverbalit i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro. Në këtë moment vjen këshilltari E. Çepele. Prezent 15 këshilltar.

Leksi-meqënëse jemi tek pikë 4, nuk është se ka ndonjë gjë tek dhënia e ndihmës ekonomike. Këta të 9 që kanë aplikuar, që kanë marr 6 % skemi çà diskutojmë. Për mua këta quhen fatkeq që janë në këtë skemë. Elmazi-të vazhdojë si është rregulli dhe procedura. Kryetari-e kërkon dikush fjalën për pyetje? Elmazi-sa i përket pikës 4 që kemi diskutuar disa herë në Këshill dhe më vjen keq që ka ngel prapë në atë vend ku ka qënë dhe nuk ka patur asnjë lloj ndryshimi, prandaj ajo punonjësja që është atje është e detyruar të zbatojë ligjin, por personat që janë në listë, duhet të paktën që dalin nga skema se nuk përfitojnë dhe qëndrojnë të njëjtët njerëz brenda në këtë, unë kam dyshim si anëtar i Këshillit dhe si Kryetar i Grupit, që mos vallë është njëri i Elmazit dhe tjetri i Afrimit? Ka privilegji të tillë brenda? Ky është mendimi im. Sp.Shërbimit Social Sonila-jo, këto janë të përzgjedhura nga sistemi i ndihmës ekonomike, nuk është se ka me mik si mund të themi, por këto janë të përzgjedhura nga sistemi i ndihmës ekonomike, të cilët nuk përfitojnë pikët maksimale dhe ne i përzgjedhin, sistemi i përzgjedh vet, nuk është se ka shumë qytetar që vijnë aplikojnë dhe përfitojnë 6%, më shumë përfitojnë ndihmën ekonomike. Tek 6% janë vetëm ata që nuk marrin pikët e mjafueshme. Elmazi-të gjithë ata që aplikojnë për ndihmë ekonomike dhe që dalin nga skema nuk përfitojnë, sa janë? Sonila-varet nga muaji. Elmazi- këtu ka fakte, sa dalin konkretisht? Sonila-varet sa aplikojnë në skemën e ndihmës. Elmazi-sa kanë dalë për këtë periudhë që ne po kalojmë? Sonila-secili ka pjesën e vet, une kam të bashkisë Roskovec, janë 4 punonjëse, secila ka qytetarët e vet që aplikojnë. Dhurata-në lidhje me atë që tha parafolsi, ka një shifër të caktuar, se ju zonjë thatë që mbuloj vetëm Roskovecin, ka një shifër? Se mesa kuptoj zotria e ka fjalën për shifër dhe jo ka disa, pavarësisht se zonën se mbuloni ju po themi Njësinë Administrative Strum, po Roskoveci a ka një shifër? Ta kemi informacionin jo për gjë. Sonila-këto janë muaj për muaj, qytetarët vijnë muaj për muaj. Dhurata-ndryshojnë ata? Sonila-po ndryshojnë. Dhurata-rritet numri apo pakësohet? Sonila-unë po flas për pjesën time të Roskovecit, neve kemi me zyrën e punësimit në Fier, nëse nuk regjistrohen tek zyra e punësimit, nuk aplikojnë dhe nuk e përfitojnë ndihmën ekonomike, sepse janë në moshë pune. Dhurata-po prapë ska shifër? Sonila-po ska shifër sepse unë mund të them që 5 familje mund të vijnë një muaj, mund të vijnë 10, mund të vijnë 7, këtë se kemi me një shifër të caktuar, varet në bazë të kërkosave të qytetarëve. Jorgo-bashkia e Roskovecit vetëm Roskovecin ka apo? Sonila-dhe Jagodinën. Leksi-dhe njësitë e tjera. Sonila-po dhe njësitë Kurjan, Strum dhe Kuman. Jorgo- tanë kjo është qesharake, vjen këtu dhe na shpjegon jam vetëm për Roskovecin, Roskoveci ka Sukun, ka Jagodinen, ka Kurjanin, nëse ke ardhur gjysmake ik, apo e kam gabim? Shpjegimi duhet të jetë jo vetëm për Roskovecin, se këshilltarët nuk janë vetëm për Roskovecin, këshilltarët janë nga të gjitha zonat dhe kërkojnë informacion, dhe zotria që bëri një pyetje e bëri me vend, mos hajde gjysmake për shpjegimet. Kryetari-z.këshilltar specialistja që ka ardhur për të prezantuar projekt-vendimin sot këtu, është specialistja e cila mbulon bashkinë Roskovec dhe nuk është e prezentuar për shifrën fikse që ne kërkuam, dhe mesa unë kuptova po përpinqet të jetë e kujdeshshme, të mos japi një shifër të përafërt. Kush dëshiron që të marri një shifër të saktë, se ato janë të specifikuara dhe të dokumentuara në kompjuter, dhe mund tja u japi nëse ju duhet një shifër. Pra nuk mund të abuzojmë me faktin që ajo nuk është e prezentuar me këtë pyetje specifike, sepse ju po e pyesni jo për ndihmën ekonomike nga fondi i kushtëzuar, por sa persona dalin nga skema e ndihmës ekonomike që është një temë tjetër, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë

nuk ka lidhje me projekt-vendimin. Kështu që mos të përfitojmë nga ky rast për ta vënë në një pozitë të papërballueshme nga një specialiste. Jorgo- më fal se ne ja morëm pyetjen këshilltarit dhe e vazhduam neve, por ne këtu shtjellojmë dhe bëjmë pyetje, marrim një informacion për të gjithë bashkinë Roskovec, jo për Roskovecin. Ne skemi gjë me të, por informacionet që duhej të vinin duhet të jenë të sakta. Kryetari-informacioni që ju po kërkon nuk është pjesë e projekt-vendimit të cilin ne po shqyrtojmë dhe do të miratojmë sot. Ju keni shumë të drejtë, informacioni duhet të jetë i asaj shkalle të përmbledhi gjithë bashkinë, por specialistja që ka ardhur për ta prezantuar nuk e ka informacionin e saktë që ju kërkon sot. Fredi-propozoj mbledhjen tjetër të dinë këshilltarët dhe numrin e saktë, jo mbledhjen tjetër por çdo mbledhje Këshilli. Maksi- sa i përket informacionit të sotëm, ne kemi ardhur përparrë jush me 9 veta për ndihmën ekonomike, siç ka ardhur çdo muaj. Pyetja ka vendin e vet. Në Komisionin e Ekonomisë përparrë se të bëhet mbledhja tjetër, jemi plotësisht dakort të japim informacion të saktë, sa kanë aplikuar, sa fitojnë në muajin Nëntor, të japim informacionin e saktë pa asnjë lloj problemi, nuk kemi pse të fshehim gjëra se nuk është puna vetëm e jona, dhe mbi bazën e atyre që nuk fitojnë do themi nuk kanë fituar 20, ne 9 kemi mundësi të ndihmojmë, po qe se ka mundësi që ne të familjarizohemi me këta të 9, mbase Elmazi ka të drejtë që thotë që pse të familjarizohemi me këta të 9 gjithë vitin 2024, mbase ka dhe vend për të korigjuar, jam plotësisht dakort që ne të vijmë me informacion më të saktë mbledhjen tjetër. Leksi-meqënëse e mora fjalën në fillim, ne e kemi informacionin këtu shterues në këtë projekt-vendim që na ka ardhur, janë 9 dhe këta 9 atje ku kanë aplikuar kanë plotësuar kriteret, se na i kanë dhënë kriteret që në fillim të vitit, kush i plotëson ato kriteret do futet tek fondi i 6%. Tani të fillojmë të zgjerojmë, ne me asnjë skemi këtu lidhje fare, me asnjë sjemi familjar me këta, këta janë fatkeq që kanë aplikuar dhe marrin këtë lloj ndihme, dhe është gjynah që ne arrijmë dhe diskutojmë sikur po bëhet gjë e madhe. Ne sa po shpenzojmë kohë me këtë, nuk shpenzojmë me ato që kalojmë gjëra më të mëdhaja. Elmazi- të nderuar këshilltar, unë nuk e ngrita problemin përtu shqetësuar dikush dhe të preket dikush, por ngrita problemin për ata që nuk janë këtu në këtë sallë dhe që kanë dhe të drejtë, sepse marrin ndihmat ekonomike, se e ke identifikuat ti apo X apo Y janë 4 apo janë 9, mbase ka më shumë se ti smë mbush dot mendjen mua, se dhe une që flas, flas mbi bazën e letrave prandaj unë kërkova nga Kryetarja ose nga punonjësja që sa dalin nga skema, ti paraqitet Këshillit ti dinë zotérinjt dhe zonjat që janë këtu brenda dhe të raportojnë në njësitë e tyre, dhe nuk është për njësinë e bashkisë Roskovec të më mirëkuptoni drejt, janë për të katërta dhe unë për të katërta dua të di. Leksi-100 herë e kemi diskutuar këtë, do vijnë emrat sdo vijnë emrat. Dhurata-unë jam dakort me këtë propozimin e fundit që tha, të informohemi çdo muaj. Unë isha e interesuar para 1 muajsh apo 2 muajsh atje për diçka, u zgjidh ai problem që unë pata në lidhje me komunitetin, dhe nga ana tjetër kërkova informacion një numër afërsisht, dhe ajo sikur devijoi çik ajo punonjësja atje, jo do ta japim këtë muaj, jo do pyes nga lart jo do pyes nga poshtë, dhe nuk e mora një numër. Maksi-sa i përket specialistes që kemi këtu, Gogo nuk kemi pse e ofendojmë për arsyen se ajo mbulon vetëm një njësi. Jorgo-nuk pata gjë me atë, por janë dhe 4 komuna të tjera. Maksi-ndaj jam dhe unë këtu, për të përfaqësuar bashkinë. Emels-Maksi nuk është nevoja për të na mbushur mendjen sesi, se qysh se tek,kjo mbyll me dy fjalë, nuk e ka informacionin e nevojshëm dhe mbaroi ky muhabet, ajo është përfaqësuesja e gjithë bashkisë Roskovec. Kryetari-ju lutem mos të bëjmë debat për këtë çështje, pasi siç ju thashë këto janë të dhëna që ju keni shumë të drejtë ti kërkon dhe të njiheni me to, por në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk kanë të bëjnë me projekt-vendimin të cilin po diskutojmë sot. Përsa i takon projekt-vendimit kërkon njeri, ka nevojë njeri të ketë fjalën e vet për pyetje e diskutime? Nuk ka. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas

materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro. Në këtë moment J.Begaj ikën nga mbledhja. Prezent në sallë 14 këshilltar.

5.Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve,të punës dhe të konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025.

Kryetari-ashtu sikundër dhe vitin e kaluar, e gjithë puna e Këshillit është e bazuar mbi një plan vjetor, të cilin besoj se ju jeni njohur me planin vjetor të vitit 2025, jeni të lutar të gjithë që kur bëni planifikimet tuaja, të keni parasysh dhe detyrimet që kemi ne si këshilltar për të marr pjesë dhe për të organizuar mbledhjet plenare, mbledhjet e komisioneve, dëgjesat publike dhe gjithçka tjetër është parashikuar në këtë plan vjetor. Ka nevojë që unë ta lexoj planin vjetor të parashikuar për çdo muaj apo jeni njohur paraprakisht? Këshilltarët shprehen se e kanë lexuar. Kryetari-për të shtuar apo për të diskutuar dikush sepse ky është një plan vjetor që do përpinqemi ta zbatojmë të gjithë bashkë, nëse dikush nga ju mendon se diçka duhet përmirësuar, duhet ndryshuar. Fredi-unë ta thashë edhe më vete dhe në grupin e këshilltarëve kam shkruar, unë bëra pyetje edhe vjet edhe sivjet në konsultimet, por unë jam i mendimit sepse kështu e përmban edhe ligji dhe rregullorja e Këshillit Bashkiak, konsultimet e Këshillit Bashkiak me komunitetin, mbledhjet që kryen Këshilli Bashkiak me komunitetin, konsultimet me komunitetin përpara miratimit të buxhetit dhe paketës fiskale, duhet të drejtohet mbledhja nga Këshilli Bashkiak, Kryetari,Nënkyetari dhe në pamundësi të Kryetarit dhe Nënkyetarit nga një anëtar i Këshillit Bashkiak. Këtu ka këshilltar edhe të vjetër që kanë qënë dëshmitar, sepse kështu e përmban ligji dhe rregullorja. Unë e kam bërë edhe vjet, jam konsultuar edhe në seminare edhe me jurist, kështu e përmban ligji dhe rregullorja. Nuk mundet konsultimet me publikun ti drejtojë administrata. Administrata bën konsultime më vete, në momentin përfundimtar na bie projekt-buxhetin Këshillit Bashkiak, kam një muaj e gjysmë kërkoj projekt-buxhetin, pse të marr unë Selman Çepele në telefon,bëra gabim dhe u bëra pishmënd që e mora. Ne duhet të kemi projekt-buxhetin të paktën këshilltarët, si të vete unë atje hu gardhi, të di diçka, aty dhe sot skam marr as projekt-buxhetin fillestar, as përfundimtar, as ai që do jetë. Ka dy muaj konsultimet me publikun, le që vemi atje, e kuption ta drejtojë mbledhjen që ka për detyrim drejtimin e mbledhjes Këshilli Bashkiak, ta drejtojë Kryetari i Njësisë Administrative ose një përfaqësues i bashkisë? Edhe vjet e kam diskutuar këtë gjë, konsultohuni në qoftë se nuk është kështu unë tërhiqem, por të jeni të bindur sepse unë e kam ngritur këtë problem, edhe znj.Mira ka qënë këshilltare kështu e kemi bërë, edhe z.Nazmi ka qënë kështu e kemi bërë. Absolutisht punonjësit e administratës janë të detyruar të jatin shpjegime, unë stë kërkoj asnjë gjë, këtë shpjegim sdo ta jat unë se ne nuk jemi specialist, nivelin e taksave, planin e buxhetit, investimet, ata do ti jatin shpjegimet, por jo ta komandojnë, e përmban rregullorja e Këshillit dhe ligji përfunksionimin e pushtetit vendor. Kryesimin e mbledhjes e bën Kryetari i Këshillit, Nënkyetari i Këshillit, në pamundësi të këtyre një anëtar i Këshillit, jo për mua por është një e drejtë që e kemi ne, kaq kisha, të paktën të jetë për vitin tjetër. Kryetari- dëgjesat publike të organizuara nga Këshilli, në pamundësi janë bashkërenduar me administratën e bashkisë, në mbledhjet që do të organizonte ajo, përfaqësimi ka qënë puthuajse në secilën mbledhje. E rëndësishme për mua është që zëri qytetar të merret nga këto mbledhje. Ju keni një të drejtë sa i takon kërkësës tuaj që keni bërë, dhe për këtë kërkësë shkurtimisht, duke qënë se kjo gjë mund të diskutohej në një moment të mëvonshëm, sa i takon projekt-vendimit të cilin ne po diskutojmë kjo nuk është e përfshirë në atë projekt-vendim, megjithatë do tju lutem që shkurtimisht tju jat një përgjigje për të dyja çështjet në

fakt, por më shumë për çështjen e parë që ju kishit si shqetësim, se dhe unë e shikoj si shqetësim, do i jap fjalën z.Maksi, dhe pastaj do vazhdojmë me projekt-vendimin. Maksi- Ekzekutivi në mënyrë kategorike nuk ka hyrë në kompetencat e Këshillit Bashkiak, ka bërë detyrimin ligjor për dëgjesat publike në marrjen e mendimeve për paketën fiskale dhe për buxhetin, në të gjitha njësitë administrative sipas ligjit. Në këto kemi patur miratimin dhe gërshtimin e punëve të përbashkëta me Këshillin, për ti bërë të dyja në një, por nuk kemi hyrë në kompetencat tuaja, ne kemi bërë punën tonë. Ndërsa ju nëse doni të bëni punën tuaj të veçantë nga Ekzekutivi, ose të organizoni takime të tjera, edhe në prezencën e specilistëve tanë jemi plotesisht dakort, të hapur në qoftë se doni të bëjmë dy dëgjesa, hajt bëjmë dy dëgjesa, por kemi marr miratimin tuaj për gërshtimin e punëve të përbashkëta. Ne kemi bërë punën tonë dhe neve nuk na lejohet të mos bëjmë dëgjesa publike. I kemi bërë të përbashkëta të gjitha takimet nëpër fshatra, pjesmarrja juaj për mua ka qënë e kënaqshme, ndërsa po të doni të bëni sipas planit që ju keni, ne ju përgjigjemi përsëri. Fredi-me fal çà po miratojmë, ky është plani jonë apo i juaji? Maksi- po është i joni, Ekzekutivi e paraqet në Këshill. Fredi-kjo pikë e rendit të ditës është plani i Këshillit. Maksi- po është i juaji. Fredi-atëherë çà po thua? Maksi-dhe unë këtë po them, kur të doni ju, të jeni gati për të bërë dëgjesa publike në bazë të planit, grafikut, Ekzekutivin e keni në dispozicion. Dhurata-ju thoni që pjesmarrja e anëtarëve të Këshillit ishte prezente, sigurisht unë isha në tre prej tyre, dhe kam ardhur në Strumë dje ju më fal që po e them por u treguat të paedukatë dhe nuk më njoftuat. Tani të vij unë 7 km, të vij deri në Strumë dje të rri aty çerek ore ky është gabimi juaj. Tani a e drejtovë ti, se Kryetarja nuk ishte, as Kryetari sipas ligjit, dhe juve smë njoftuat fare. Unë sjam ndonjë fëmijë rrugësh, dhe fëmija duhet trajtuar me dinjitet se ka personalitetin e tij. Maksi-unë të kam kërkuar ndjesë. Dhurata-kur e kërkove ndjesën, kur të mora unë në telefon që po rrija po prisja atje, kjo nuk është e drejtë pra, është mosvlerësim. Maksi-unë të kërkova ndjesë. Dhurata-po si kërkohet ndjesë në momentin e fundit? Maksi-të kam kërkuar ndjesë si Nënkyetar i bashkisë, thashë do shtyhet 1 orë. Dhurata-nuk më ke njoftuar i nderuar, marr sekretaren i thashë do ta bëjmë mbledhjen, se vetëm unë isha atje tek sheshi, pse çfarë jam unë? Maksi-u shty 1 orë për arsyen organizimi. Dhurata-po të më kishe njoftuar. Kryetari-Dhurata jam njohur me shqetësimin tuaj dhe kjo qëndron, kjo është papërgjegjshmëri. Dhurata-kjo është padrejtësi, të rri une të pres atje, të tallen ata atje. Kryetari-unë nuk e besoj, është çështje administrative, por do ju lutem mos ta trajtojmë tanë, sepse po dalim nga rendi i ditës. Maksi-edhe Kryetari i fshatit dhe organizatorët e tjerë ishin me një problem pune të veçantë. Dhurata-njoftohet të paktën çerek ore para. Maksi-po unë të kërkova ndjesë, 1 orë u shty. Kryetari-z.Nënkyetar ju lutem ti përmbaheni përgjigjes shkurt sa i takon pyetjes që kishte këshilltari. Fredi-pjetjen e parë që bëra për materjalin, që akoma nuk e kemi, kush është arsyja? Ka dy muaj që konsultohet me publikun dhe këshilltarët nuk kanë informacion. Maksi-të diskutosh me publikun merr vërejtjet, kërkuesat, sugjerimet, propozimet dhe pastaj pasqyrohen në relacionin përfundimtar që do i vij Këshillit Bashkiak. Relacion përfundimtar për buxhetin nuk ka, jemi në fazën e përmbylljes. Fredi-paraprak? Maksi-po ka. Fredi-ore paraprak, atë çà diskutove ti, se fillimisht çà diskutuat ju? Maksi-deri në Dhjetor do ta mbyllim dhe do ua japim, sot po diskutojmë për taksat dhe tarifat. Fredi-çà po diskuton ti me këto, nuk po diskuton sa janë tarifat?taksat dhe tarifat vendore nuk janë të buxhetit? Maksi-po, sot po vijmë tek ju me këto taksa dhe tarifa vendore, të marr në diskutim me gjithë komunitetin. Fredi-ore materjalin pse mos ta kishim, taksat dhe tarifat ta kishin këshilltarët, edhe materjalin e buxhetit paraprakisht, kam marr 20 herë në telefon sekretaren. Maksi-unë e di që kanë qënë para jush taksat dhe tarifat vendore, nuk ka ndryshime ka vetëm disa shtesa. Fredi-po nuk është hera e parë, kemi 20 e ca vjet znj.Mira dhe

z.Nazmi i kemi pasur gjithmonë materjalet. Maksi-pa kaluar pakëta fiskale nuk mund të bëhet buxheti paraprak, sepse duhet të miratohet paketa fiskale, taksat dhe tarifat vendore dhe mbi bazën e tyre janë të ardhurat, grandi ska ardhur akoma, taksat dhe tarifat vendore nuk janë miratuar akoma, si do bëjmë buxhet? Dy janë të ardhurat kryesore, grandi i qeverisë që ska ardhur akoma dhe paketa fiskale që do miratohet sot. Kryetari- para se të vazhdojë po ju kujtoj se përpara se të merret inisiativa për dëgjesë publike, njëkohësisht administrata ka për detyrë që të publikohet në faqen zyrtare projektakti i cili do të hidhet për konsultim publik. Pra këto që ne sot i kemi këtu, njëkohësisht para fillesës së dëgjesave publike, janë publikuar të gjitha në faqen zyrtare. Fredi-lëri publikimiet unë dua materjalet para, materjalet fizikisht. Kryetari-ju i doni të printuara e kuptoj kërkesën tuaj, thjesht po ju bëjmë me dije që kjo paketë fiskale me të cilën ne dolëm në konsultimet publike, në bashkërendim me atë axhendë që kishte përcaktuar Ekzekutivi, është publikuar në bazë të kërkesës ligjore që kishte, në faqen zyrtare të bashkisë. Kërkesën tuaj unë e gjej absolutisht të drejtë, dhe as vet nuk e kuptoj arsyen se pse mos tju jepej një kopje fizike, përsa kohë ajo është diçka e publikuar dhe nuk është se do dilte posaçërisht vetëm për ju. Të nderuar këshilltar jemi tek pika 5 e rendit të ditës, sa i takon miratimit të planit vjetor të aktiviteteve, të punës dhe konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025. Të nderuar këshilltar ka dikush nga ju ndonjë vërejtje, ndonjë sugjerim, diçka për të diskutuar në lidhje me këtë plan pune? Ky është plani i punës i joni, këtu skemi si të kapim administratën, e kemi për veten tonë dhe duhet që të përpinqemi maksimalisht që ta realizojmë këtë plan pune. Maksi-dhe ndihmën tonë do ta kemi maksimale. Kryetari-faleminderit z.Nënkyetar. Atëherë në qoftë se pyetje, diskutime, sugjerime të tjera nuk kemi për këtë plan pune, të nderuar këshilltar ju ftoj të votoni projekt-vendimin. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

6. Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.109 datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe të ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2024”, të ndryshuar.

Maksi-të nderuar këshilltar para jush vijmë me këtë kërkesë në Këshillin Bashkiak, për ndyshimin e numrit të punonjësve në një nga ndërmarrjet që kemi, në ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale, është me një fuqi punëtore prej 32 punonjës, kërkjmë të shtojmë 7 punonjës, 3 specialist murator dhe 4 punonjës të thjeshtë për kryerjen e 2 investimeve. Ne kemi fituar 2 projekte nga FSHZH për ndërtimin e paisazhit të biçikletave dhe kalimin e këmbësorëve në fshatin Suk, tek materniteti. Dhurata-tek materniteti? Po ajo e mbaruar është apo do ta shkulni prapë nga e para? Maksi-nuk shkulet ajo, është paisazh i biçikletave që do kaloj në të gjithë territorin, është projekt i gatshëm, si dhe në rivitalizimin e lisenit të Kurjanit, i cili bën të mundur lidhjen e Kurjanit me pyllin e Luarit. Baza materjale e këtyre 2 investimeve është e siguruar nga FSHZH, punimet do të kryhen nga ndërmarrja jonë e Shërbimeve Komunale, dhe për këtë në kushtet që ne kemi vetëm 32 punonjës në këtë ndërmarrje, kërkjmë 7 veta shtesë. Pagesat bëhen në Janar, prandaj skemi ardhur të shtojmë fondin e pagave për Dhjetorin, se pagat e Dhjetorit merren në Janar, dhe kërkjmë ta zhvillojmë ta bëjmë këtë për vitin 2025, ti mbyllim të dyja këto projekte me FSHZH. Baza materjale ka ardhur, kërkohet vetëm fuqia punëtore nga ana jonë si bashki. Besoj dhe po ua them paraprakisht me bindje të plotë, nuk ka fare të bëj me fushatë se jemi në Dhjetor të 2024, nuk ka të bëj fare me fushatën se po marrim 7 fuqi punëtore, po marrim 3 specialist të mirëfillt murator dhe 4

punonjës krahu, që do të merren me të dyja këto investime, pra janë projekte të fituara nga FSHZH. Dhurata-ju thatë që do shtojmë dhe 7 punëtor të tjerë, mesa shoh unë të paktën brenda bashkisë tonë, se unë qarkulloj me makinë dhe shoh shumë punëtor që rrinë përgje-përgje ulur për qejfin e tyre. Unë skam parë ndonjëherë punëtor se të paktën unë mbuloj arsimin dhe të gjithë arsimtarët futen nëpër klasa dhe kridhen me shkumsa, apo mos të flas për këta të shëndetësissë, apo ju që jeni brenda bashkisë që qëndroni vigilent në çdo orë, dhe realisht ashtu duhet sepse paguheni. Ju thoni 3 murator dhe nga ana tjeter thoni që do bëhet një korsi për biçikletën, tani pse janë të domosdoshëm këta murator? Kur unë kam parë që është shtruar trotuari para maternitetit, konkretisht ju thoni që do shtrohet atje, unë sdi ku do shtrohet më sepse ka mbaruar ajo punë se kaloj atje 7 herë në ditë, se atje është dhe institucioni arsimor dhe ju e dini mirë, ndërkohë që ka plot për tu bërë, që po bëhet stadiumi se është në vazhdim e sipër. Ne na vijnë 70 nxënës nga Senkallarët dhe Toskallarët e Sukut 2, ata rrezikojnë jetën nuk e di sa jeni të informuar ju, nuk mund të shtohet diçka atje, minimumi nuk mund të bëhet trotuari deri atje? Lëre poshtë zona e Sukut njëherë, po nuk di se ku kërkoni konkretisht, ku do ta hidhni, më thuaj Maksi të lutem? Mendova se mos the në lagjen Agaçaj se ishit vet në lagjen Agaçaj, ose nga Sakallenjt poshtë andej, se janë të shkretët nga 10 familje dhe ata janë për faqe të zezë, me gropë me gjëra si para çlirim, por ama përpara maternitetit është e kot ta thuash, ku, çfarë do bësh, këtë kam pyetje? Maksi-nuk të thashë para maternitetit, është në Suk. Dhurata-po nuk e ke të përcaktuar, ku në cilën zonë ma thuaj? Maksi- në Suk 2 nga rruga që kthehesh tek komuna deri tek..Dhurata-në Suk 2, do bëhet atje? Maksi-po do bëhet atje. Dhurata-e sigurt? Sinqerisht është arritje nëse ti e bën. Maksi-Këshilli i Bashkisë duhet të na falenderoj që ne kemi fituar projekte, se nuk janë lekët e bashkisë por janë lekët e FSHZH. Dhurata-jemi mirënjohës dakort, por jo falenderues. Maksi-ne kemi fituar projektet, bazën materjale e kemi të siguruar 100% nga FSHZH. Dhurata-në Suk 1 nga lapidari deri poshtë tek Rukanjaret i shoh ata punëtorët se shumica janë nga Roskoveci, kalon një makinë ngrihen dhe ulen gjithë ditën, mirëpo ti thua do ta kalojmë atje, por më duket se nuk je në dijeni as vet mesa pasië sepse ti the tek materniteti. Maksi-deri tek materniteti thashë, nga njësia administrative deri tek materniteti. Dhurata-nuk përmende as Sukun 2 të paktën. Maksi-nëga kthesa e njësisë administrative deri tek materniteti, nga shtëpia e Flamur Kocaqit deri tek karburanti, rrëthrrrotullimi. Pra është një projekt i fituar nga FSHZH. Dhurata-po punëtorët ishin domosdoshmëri patjetër? se duhen mjeshta, duhen muratora për të shtruar ato pllaka trotuari. Do thoja ishte domosdoshmëri për murator dhe shtimin e këtyre punëtorëve? Se deri dje kush i bëri këto? Apo ishin të ngarkuar këta të tjerët se po rrinë rrugës këta, marrin atë pagen dhe ska gjë, se na duhen apo hë lëre se ky është gjynah. Maksi-nuk është për gjynah. Dhurata-po jo se ashtu jeni shprehur, unë personalisht kam folur me ty dhe hë se gjynah. Maksi-është fat i madh që ne kemi marr ato materjalet. Dhurata-se vë në dyshim, të thashë që jemi falenderues. Kryetari-a mundem të shtojë vetëm diçka, për ta qartësuar se kërkova informacion edhe unë se çà po ndodhete. Në FSHZH mund të aplikosh në forma të ndryshme. Një formë është që ti bën projektin dhe tenderohet një firmë, e cila me punëtorët e vet, me mundësitet e veta ta jep të përfunduar. Kuptohet që shifra që tenderohet është shumë herë më e lartë, sipërfaqja që ti mund të ndërtosh është pak më e vogël se duhet të paguash dhe punëtorin. Është menduar që të aplikohet vetëm për bazën materjale dhe punimet të bëhen nga bashkia, nga punonjësit e Ndërmarrjes Komunale. Një punë e shtuar që ka të bëjë me 2 projekte kaq të mëdhaja siç është ai dhe pjesa tjeter që do lidhi Kishën e Kurjanit me pyllin e Luarit, nuk mund të përballohet dot nga punëtorët e kësaj ndërmarrje. Pra dhe llogjika që punëtori i një ndërmarrje tjeter të jetë i papunë në një kohë, nuk mund të shkoj nga atje këtu, se

është ndërmarrje tjetër, dhe besoj se këtë e kuptojnë të gjithë. Në këtë kuadër ta keni të qartë se çfarë po ndodh. Po ndodh që si projekt është fituar vetëm baza materjale, është bazë materjale e madhe, nuk mund të pretendojmë ta bëjmë me njerëz që sjanë profesionist. Dhurata-ku ndodhet kjo baza materjale? Maksi-baza materjale çimentoja e kemi depozituar tek pika që kemi ne, pllakat do të vendosen aty në vend ku janë, dhe do të vijnë tek shkolla juaj baza materjale. Dhurata-dhe sa do zgjasë ky projekti? Maksi-është 1 vit, në 2025. Dhurata-shpresojmë të realizohet. Maksi-do ta realizojmë sesbën, se ata që japidin bazën materjale kërkojnë dhe llogari nesër. Dhurata-opo llogaritë i kemi parë ne, se tek shkolla jonë po bie muri prapë, ti e pe situatën, po na bie mbi kokë si miell. Elisabeta-besoj se gjerësia e rrugës, sa do marri trotuari janë të përcaktuara. Maksi-është në projekt, është fat i madh që i kemi fituar. Fredi-e para a është tenderuar? Sepse unë nuk di që FSHZH të japi llaç e tulla, unë nuk e kam dëgjuar dhe më duket si e padëgjuar kjo që FSHZH të japi llaç, çimento dhe tulla. A është tenderuar investimi, X lekë është tenderuar apo jo, a është premtuar apo është tenderuar? E dyta në mbledhjen e kaluar znj.Kryetare e bashkisë më tha që ju gënjeni, kur numri i punonjësve të bashkisë është 386, sepse ja thashë, ju sapo gënjet më tha, ja që nga materjali juaj del që numri i punonjësve të bashkisë është 386 apo jo? Numri që financohet nga buxheti i bashkisë është 386, ajo më kupton shumë mirë mua por përdor llafollogjinë, por vet me dokumentat e saj ose të administratës e pranon që numri i punonjësve të bashkisë është 386. Numri i punonjësve është shumë i fryrë, administratë më të fryrë se kaq unë nuk e kuptoj, doni akoma dhe 7 punonjës? 7 punonjës minimum meqë e thatë 1 vit, me pagën minimale i thonë 42-43 milion lekë të vjetra, e kupton?Kemi kaq punonjës të bashkisë që mos të bie video këtu, i kam kapur me video që kanë punuar në punë private, në bahçe të X administrator, ose tjetrit e tjetrit, edhe e kupton përdoret për fushatë, për shpenzimin e lekëve. Një çezëm kam kërkuar në Ngjeqar dhe është turp i zotit. Miratoni me një firmë këtu, duke qarë hallin jo FSHZH jo kjo 43 milion lekë, është bajate fare. Pagën maksimale e miratuar herën e parë e hodhët në xhep, kërkoni edhe këtë? Nuk bëtë një çezëm atje në Ngjeqar, pa pikën e ujit 300 familje, talleni e sot kërkoni 45 milion lekë të vjetra, dhe ma kaloni duke qeshur, por nuk është duke qeshur është burrëri. Maksi-se do punësojmë 7 veta? Fredi-në qoftë se është punësuar vazhdo punësoi pastaj, se fillon fushata. Maksi-unë ta sqarova përfushatën, por megjithatë është fat thashë edhe njëherë që fituam këto 2 projekte nga FSHZH. A është tenderuar apo është bërë proces tenderimi, e ka bërë FSHZH nuk e bëjmë ne. Kemi marr bazën materjale dhe është fat që kemi marr bazën materjale, dhe nuk është eksperiencia e parë. Fredi- është tenderuar apo jo? Maksi- e ka tenderuar FSHZH. Fredi-na bier tenderimin. Maksi-skemi punë ne me tenderimin, spo miratoni tenderimin. Fredi- jo jo, që të na tregosh ti që është miratuar apo jo, është tenderuar apo jo, ti spo më thua as këtë. Maksi-nuk është eksperiencia e parë, të paktën është eksperiencia e dytë, se në rrugën e liqenit të Kurjanit e cila ka filluar nga diga deri në hyrje të Roskovecit, është bërë tenderimi po me të njëjtën gjë që i ka bërë FSHZH,dhe të gjitha punimet i kemi bërë ne si bashki. Fredi-me ata punonjës bëj edhe këtë. Maksi-nuk kanë mundësi se ata po punojnë për këtë, po punojnë në Marinëz për atë investimin që bëmë për linjat elektrike, këta punonjës janë të tërë. Emels-nuk kemi mundësi ne Maksi që këta 7 punonjës ti marrim nga një drejtori tjetër, sepse po ti vësh re të gjitha godinat që kemi këtu në Roskovec, tek bashkia e vjetër që është muzeu sot ka një roje, tek kinemaja një roje tjetër,tek kopështi një roje, këtej ruajnë nja 5 stola me një roje atje poshtë. Po të marrësh pagën që merr ai punonjësi atje, vete shumë herë më shumë se dëmi që mund të bëhet në qoftë se do vidhet apo do shkatërrohen stolat që ruan ai roja aty. Tani nuk mundemi ne, nuk kemi ne specialist siç thua ti 3 murator, që ti marrim nga diku tjetër dhe ti përdorim për të kryer këtë punë? Kryetari- më lejoni që ti referohem projekt-vendimit që ju

keni pasur në dispozicion dhe tjua ndaj këtë numrin e punonjësve sipas këtyre zërave : bashkia Roskovec pra administrata ka 132 punonjës, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Mjedisit 70 punonjës, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale ka 32 punonjës, pra kjo ndërmarrje është pikërisht që kërkon shtimin e këtyre 7 punonjësve, dhe këto roje që neve diskutojmë, që mund ti marrim nga roje dhe ti çojmë atje, mua vet më duket e pamundur sepse është detyrim ligjor që ti ta ruash objektin. Emels-nuk mund të bëjmë dot një menaxhim të brendshëm për këtë punë, që mund ti marrim këta ustallar që thua ti, ti punësojmë edhe gjatë kohës..Maksi-për ustallar është më shumë se e vështirë se nuk gjen. Emels-jo flas këtu për të kursyer disa lekë, se janë lekë për tu paguar nga ne. Maksi-ne e kemi parë të arsyeshme që këta 7 punonjës janë të domosdoshëm se janë 2 investime. Emels-se numri i punonjësve është tej mase i fryrë, është bërë një reformë për këtë punë, me qëllim shkurtimin e numrit të punonjësve dhe ne e kemi shumëfishuar, se këto janë lekë që duhen paguar nga ne. Maksi-mendimi i Ekzekutivit është i tillë, dhe propozimi që nuk ka mundësi nga ti heqi punonjësit, se mund ta heqesh rojen që është 24 orë punon në një vend.. Emels-tani mos të abuzojmë me fjalën se unë mora një shembull konkret, por mund ti marrim thashë nga një ndërmarrje tjetër, për të kursyer disa lekë më tepër. Maksi-po ja që duhet edhe kjo se janë 2 investime kolosale. Emels-sepse ngjan sikur sa herë që ka fushatë na kërkohet që të shtohet numri i punonjësve. Maksi-unë ua thashë, ua ktheva një përgjigje që thashë sinqerisht nuk është për fushatë, se po fillon në Dhjetor të vitit 2024 dhe do mbarojë në gjithë vitin 2025. Fredi-meqë z.Maksi e pranoi edhe vet që një pjesë e punimeve tek Kisha është realizuar me punonjësit e bashkisë..Maksi-jo tek Kisha, të thashë tek rruga e liqenit deri tek diga. Fredi-po deri tek diga është realizuar me punonjësit e bashkisë. Unë jam i propozimit që të vazhdohet me ata. Maksi-po nuk ka mundësi se ata nuk kanë mbaruar akoma. Fredi-unë të thashë që kam video që punonjësit e bashkisë kanë punuar, mos i shton punonjësit sepse të kursejmë ca lekë.Nuk kërkoj asnjë gjë as për vete as për gjë, por problemi është se janë ca lekë, që me një të rënë të lapsit këtu miratojmë ca lekë dhe janë shumë lekë. Maksi-nuk janë shumë lekë se i bëra një llogari tani, 33 i bie. Fredi-po sigurimet? Do ti lësh pa sigurime ti ata? Unë po them me sigurime, unë sjam ekonomist por pagën minimale thashë, dhe e kuption unë jam kundra kësaj. Meqë ju e pranuat vet që punimet diku janë bërë. Maksi-po bëhen thashë. Fredi-ashtu bëj prapë, kjo bashkia jonë ka vajtur shto ujë e shto miell me një të rënë të lapsit. Përveç ujësjellësit bashkia Roskovec me 3 qendrat administrative ka pasur maksimumi 160 punonjës, përveç ujësjellësit.Ne përveç ujësjellësit kemi vajtur 387. Maksi-po pastrimin e kemi pasur? Se kemi dhe punonjësit e pastrimit. Fredi-unë po them 160 me 300, se ju po kërkon 393, e kuptioni sa e keni fryrë bashkinë? Maksi- kanë kaluar edhe edukatoret, rojet e shkollave. Fredi-i kemi pasur rojet e shkollës, i kemi pasur pastrueset e shkollës, ka pasur ndonjëherë pa roje, pa pastrues shkolla? 160 tre qendrat administrative përveç ujësjellësit, me gjithë bashkinë. Maksi-do bëjmë një marrëveshje bashkë që të ulemi një ditë, qoftë edhe në Komisionin e Ekonomisë dhe ti shikojmë, a kanë qënë 160, se nuk ka mundësi, që i gjithë ujësjellësi ka pasur 80 veta në atë kohë. Fredi-unë të thashë përveç ujësjellësit, se dhe këtu tek 386 nuk e ke ujësjellësin. Maksi-Ndërmarrja Komunale ka pasur më shumë se kaq. Fredi-ke informacion?mblidh informacion se unë vet kam marr informacion. Kryetari- Maksi ngelet për ta parë. Elmazi-sa i përket materjalit që na është paraqitur, në radhë të parë unë jam plotësisht dakort që materjali të kalojë ashtu si është paraqitur, sepse është nga fondi i zhvillimit dhe ne po bëjmë fjalë për 7 punëtor, të cilët duhen për të kryer punimet atje. E dyta që do më dhimbshesh më shumë, jo më shumë se të gjithë këta që janë këtu, kur përgojohet një punëtor bën këtë apo bën atë. Unë them në syrin tim, në vëzhgimin tim nga Ngjeqari deri në Arapaj punëtorët i kam parë nëpër vendet e punës dhe nuk i kam parë rrugës. Ne si këshilltar a

mundet që ta kalojmë në një zë tjetër? Nuk kalon se ky është nga fondi i zhvillimit. Ne bëjmë sherr për 7 punonjës, 4 vjet 160, po mirë ne para 4 viteve tek kinemaja aty dilte uji që vishnim çizmet, para bashkisë ishte plot me plehra. A ka që të bëhen gjëra të mira për brezat që do të vijnë? A ka të bëhet ai kanali i Vidhishtës si është ai i Vicenzës me beton nga të dyja anët dhe me ujërat e zeza që dalin në kanalin e madh? Këtë duhet të kërkojmë ne si Këshill, si ta rrisim mirëqënien e popullit tonë, dhe nuk jemi ne pse kaloi këtu apo aty përfushatë, çà fushatë pse me 7 punëtor do bëjmë fushatë ne? Nuk bëhet me 7 punëtor, as me 10 punëtor fushata. Emels-me 400 bëhet. Elmazi-me 400 e 500 bëhet, po është shumica. Emels-po i paguan ti ata, paguaj ti pastaj. Elmazi-i nderuar këshilltar, nuk ka nevojë Partia Socialiste as për 4 as për 5 meqë hyre në politikë, unë nuk dua të hyj në politikë. Unë jam për ata që më kanë zgjedhur dhe kam përdetyrë të mbrojë ata që më kanë zgjedhur, dhe tu them atyre që ata kanë të drejtë, i duan këto zhvillime. Vendi duhet të zhvillohet dhe vendi nuk zhvillohet duke u ngrënë ne me njeri-tjetrin. Nëse ka abuzim ka gjykata prandaj janë institucionet shtetërore, shkon na hidhni dhe përgjigjet atje, kurse këtu ne marrim vendime si Këshill, dhe unë mendoj të kalojë, dhe ju z.Kryetar duhet ta hidhni në votë. Emels-duket si e imponuar kjo pjesa, sepse duket sikur ne jemi kundër investimit, ju me një fjalë jeni ata që doni zhvillim dhe ne jemi kundra zhvillimit. Absolutisht nuk jemi kundër investimeve ne, aq kur e thua dhe vet që është një investim që do vij nga FSHZH, mirë na bëhej edhe ne. Ne kërkua që kjo nuk mundet thamë që të bëhet me punonjës, sepse mendoj që bashkia i ka kapacitetet, e ka numrin e punonjësve dhe mund ti marri thashë nga një drejtori tjetër dhe ti çojmë atje. Ne nuk abuzuam me pjesën tani që me këta 7 njerëz do bëhen çudira, nuk jemi kundra këtyre ne që të punësohen sepse këta do bëjnë fushatën, do bëjnë njerën andej-këtej si u përdor, skishte lidhje fare me atë pjesë. Ne thamë a është mundësia?sepse duke pasur parasysh që kemi një numër të fryrë punonjësish dhe këto janë lekë që do paguhen nga taksapaguesit, janë lekë që do paguhen nga ne. Kryetari-nëse ma lejoni diçka që mendova kur po e shikoja projekt-vendimin ishte kjo: Mund të fitohej një projekt i cili ishte i përfunduar dhe do bëhej me punonjës që sdo ishin nga komuniteti jonë. Unë vet e pashë me syrin pozitiv, mu bë qejfi sepse do ndërtohet diçka e cila do ti japi mundësinë edhe të punësimit 7 familjeve. Llogjika juaj qëndron absolutisht, në qoftë se ka vend për të parë ngarkesën e punës që ka secili punonjës, ne këtu kemi NënKryetarin e bashkisë, le të shikohet edhe ajo mundësi sa i takon ngarkesës. Fredi-meqë z.Elmaz e ktheu ashtu diskutimin, e thashë përfushatë sepse Kryetarja mund ti ketë premtuar dikujt përfshirë ta futur në punë, nuk kam punë unë as me Partinë Socialiste as me Partinë Demokratike, por në këtë sallë unë kam kërkuar 6 çezma në fshatin Ngjeqar, 240 familje dhe këto minimalisht me 6 milion lekë që të pinte ujë ai fshat.Gjithë ai behar ja z.Nazmi është vet dëshmitar, është pa ujë ai fshat dhe nuk më mbështeti asnjeri nga ju, as Kryetarja, dhe kur qënka përfshirë 40 e ca milion lekë, u bëkan tragjike gjërat. Është gjendja kështu si them unë dhe nuk gënjej, u hodha një video të gjithë anëtarëve të Këshillit, përfshirë 1 çezëm në kroin e fshatit Ngjeqar është tallur firma atje, janë hedhur lekët si në kohën e Haxhi Qemalit turp i zotit, e sot merret sikur po kërkojmë ne këtu. Skam unë punë as me parti as me gjë, janë shumë lekë, me 6 milion lekë do kishte pirë ujë fshati Ngjeqar me bidon. Është tragjike, kanë hapur një gropë atje tek kroi i fshatit dhe mbushin ujë, që mos o zot të vej tjetri të hedhi helm atje. Elmazi-e pashë. Fredi- e pe ti e pe ,po se ke parë mirë, se po ta kishe parë nuk duhej të kishe thënë kështu Elmaz, më the ti mua me partinë, unë skam punë me partinë, ky është hall mbi hall dhe sqankan para fare këtu 40 e ca milion lekë se po punësohen 7 punonjës, po ajo që them tani të hedh video unë këtu?lëre çà thua ti tani se spo i bëjmë reklamë as punonjësve, as po mbrojmë se e mbrojnë veten vet këta, unë po të them ajo që kam parë unë, ta hedh unë vidion dhe ta shikosh ti, por unë sdua të bëhem as

hakmarrës, as të heq punonjës nga puna por ama gjykonit, sepse ne nuk jemi kundër investimeve, siç e ka bërë me ata punonjës ashtu ta bëj. Ka një vendim për punonjësit e ndihmës ekonomike, që janë në ndihmën ekonomike që seleksionohen nga zyra e punës, ta bëjnë punën ata, por na u dashkan këta punonjësit e kualifikuar. Këto janë gjëra bajate, justifikime për tu shtuar administrata, unë kështu e kuptoj dhe kështu është, nuk ka punë as ekzagjerimi këtu as me partitë. Maksi-mos abuzo të lutem. Fredi-asnjë çik nuk abuzoj, abuzim është ai që të punosh tokën me punonjësit e bashkisë. Maksi- këtu nuk do të lejoj se jam Nënkyetar i bashkisë, që të thuash kam video por e mbaj këtu për këtë apo për atë. Fredi- jo jo e bëj publike unë. Maksi-o tregohu siç është për tu treguar serioz si këshilltar, shashka mos hidh. Fredi-serioz jam, çà them unë kam fakte. Maksi-ke fakte nxirri. Fredi- kam fakte që janë hedhur një thes me lekë tek çezma e fshatit, dhe atje nuk është bërë asnje investim, është tallje. Kam fakte që punonjësit e bashkisë i kam kapur në punë private. Maksi-me gjithë respektin që kam por po qe se hedh shashka më mirë nxirri. Fredi-ska shashka fare këtu, ja tek i ke të gjithë anëtarët e Këshillit këtu për vidion e çezmës, edhe atë e hedh. Të dish një gjë unë pa fakte nuk flas, mos ki merak se do ta hedh dhe vidion. Maksi- po hidhe. Elmazi-meqë më zuri emrin dhe jam i detyruar ti kthej përgjigje kolegut të nderuar. Unë nuk jam për të mos u bërë çezma në Ngjeqar dhe nëse e do pensionin tim unë e jap për atë fshat atje, se kam qënë vet dhe kam punuar, atë duhet ta shikoj bashkia mirë me prioritet. Ama nuk jam dakort që ti të thuash unë e kam këtu, dhe unë thashë ka organe kompetente për këtë. Po për atë atje jam me të dyja duart, nëse duhet dhe pensionin tim e vë atje. Fredi- Elmaz u miratua këtu, ishte një investor tha do jap 2 milion lekë dhe Kryetarja se pranoi. Kryetari-të lutem që mos të dalim edhe njëherë nga tema, që dhe fjalët që ne themi këtu të zënë vend. Leksi-në projekt-vendimin që jemi në fjalë, normalisht që e kemi të argumentuar pjesën e shtimit të numrit të punonjësve, dhe sa po merremi tani me këta 7 punonjës, është e drejta e kujdo të punojë dhe mos ti paragjykojmë që i kemi përfushatë apo si kemi përfushatë. Normalisht dhe shqetësimi i kolegut Fredi për pjesën e ujit është tamam shqetësim i madh, sepse atje është dhe një komunitet që jeton, na e dha fjalën edhe Kryetarja e bashkisë që duhet të investohet. Por meqënëse këto fonde që kanë ardhur nga FSHZH janë të përcaktuara, nuk kemi arsyë pse të bëhem pengesë për hatë të 7 punonjësve që do punësohen. Ne është gjë e mirë që ti kemi punonjësit, të punësohen dhe të mos largohen, se ndryshe është kur largohen jashtë shtetit kontribojnë andej, ndryshe është kur punojnë e kontribojnë këtu në vendin tonë. Prandaj si ato investime andej, dhe unë që kam shqetësimin e komunitetit për Unazën Perëndimore, ka kaq kohë që nuk bëhet, të shikohen me prioritet ato, dhe në një moment tjetër ndaç nga FSHZH, ndaç nga investimet në bashki të vijnë në Këshill, të bëhen sepse janë njerëz që jetojnë dhe punojnë në atë vend. Prandaj unë nuk kam se çà të zgjas më përkëtë, përderisa ata na e kanë sjellë të argumentuar, arsyjeja pse shtohen këta punonjës, unë jam dakort me projekt-vendimin. Dhurata-ne si grup kemi vendosur të jemi dakort me investimin që do bëj FSHZH, por jemi kundër përshtimin e punonjësve të bashkisë. Nuk ka më diskutime. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 11 vota pro, 3 vota kundër Dh. Malka, E. Xhaxhaj, F. Feleqi. Miratohet.

7. Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2025.

Dr. Ardhurave Vendore Orgesa sqaron projekt-vendimin. Ky projekt-vendim synon të adresojë disa objektiva kryesore, në përmirësimin e sistemit të taksave dhe mbështetjen ekonomike të vendit. Në këto objektiva mund të përmendim : zbatimi i politikave fiskale, harmonizimi i qëllimit dhe ligjt

fiskal, përcaktimi i tarifave dhe normave specifike, mbështetje për kategori të veçanta. Elmazi-ne e kemi materjalin, nëse ndonjëri ka paqartësi, lër tja drejtojë punonjëses. Fredi-po jam dakort. Kryetari-shkurtimisht atëherë nga sa kam marrë pjesë në dëgjesa, e keni vënë re që nuk kemi ndryshime të tarifave, vetëm shtim të disa kategorive që nuk janë parashikuar në paketën fiskale të mëparshme. Maksi-taksat dhe tarifat vjetore për familjet do të janë njëlloj si në 2024, janë disa taksa dhe tarifa vendore që kanë kaluar në dëgjesa publike, që Orgesa mund ti thotë se kush do janë taksat e reja, por jo për familjarët. Dhurata- këto i kemi lexuar ne. Kryetari-në qoftë se ju i keni të qarta, kalojmë në pyetje. Dhurata- kam dy pyetje :1.Për tokat anës lumi, do paguhet taksa 70% tha Orgesa, po për ato toka të cilat janë zhdukur? Kërkesa ime është paraqitur që në Gusht dhe jemi afërsisht në muajin e katërt dhe unë se kam marr një përgjigje. Çfarë do të ndodhi me ato toka të cilat janë zhdukur nga gjerryerja, erozioni i lumi? Orgesa-paketa fiskale prek vetëm tokat bujqësore. Dhurata-tokat e zhdukura nuk janë përmendur fare në paketën fiskale. Orgesa-këtu përfshihen të gjitha tokat bujqësore të cilat preken nga lumi Seman që përmbyten, ato paguajnë 70% gjithë vitin, jo si pjesa tjeter që 70% e paguajnë deri në 30 Qershori. Për pjesën tjeter çdo ankesë që bëhet, ngrihet një komision i cili bën verifikimin, dhe nëse ata bien dakort që e gjitha kjo tokë është e zhdukur, ky relacion pastaj kalon në Këshill dhe i vjen informacion zyrës së tatim – taksave, të cilët merren me procedurën e heqjes së taksës bujqësore. Dhurata-më fal ishte Kryetarja këtu në Shtator që unë e kam ngritur si problem dhe tha se dija e të tjera me radhë, ndërkohë po bëhen 4 muaj dhe skam marr asnjë përgjigje. Kur do e marr përgjigjen? Orgesa-e keni bërë një ankesë, është një komision që është ngritur për verifikim. Dhurata-kur e jep përgjigjen, apo të shtyhet edhe ca kohë? 2. Në këtë paketë fiskale ju keni vendosur taksa dhe tarifa nga të cilat mund të përmendim : taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksë trualli etj., ndërkohë kalojmë tek tarifat : tarifa e regjistrimit të biznesit, tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, vaditje etj. Pyetja ime tjeter është në lidhje me taksat që keni marr dhe do të merrni, a jeni në dijeni sa është numri i familjeve që paguajnë taksë ndriçimi, gjelbërimi nëpër fshatra dhe konkretisht në fshatin Suk1? Sepse sipas ankesave të qytetarëve, i paguajnë këto taksa dhe shërbim nuk kanë marr asnjëherë, situata është reale se realisht ju ishit në dëgjesa publike, isha edhe unë bashkë me ju. Nëse shkon natën në fshatin Suk 1, kryesisht në lagjen Agaçaj rrezik do përplaseni me njëri-tjetrin. Ju e dini mirë që është zonë e populluar as 10% e banorëve si kanë braktisur shtëpitë e tyre, janë atje. Kur kalon natën atje është një terr i vërtetë, ke frikë të kalosh sepse rrezikon, mund të përplasesh me një bicikletë, motorr apo me makinat, duket tamam si në vitet 80 dhe është për të ardhur keq. E kemi kërkuar herë pas here në dëgjesë publike, dhe unë e kërkova por se ka vënë ujin asnjëherë në zjarr Kryetarja e bashkisë. Pse minimumi nuk vendosen 5 ndriçues në atë fshat, se sipas jush rrugëve të gjelbërimit dhe të ndriçimit si ka ardhur akoma radha, se thoni gjithçka është me radhë. Apo kujtoni se qytetarët janë të kënaqur me vizitat që beni ju, kryesisht Kryetarja e bashkisë. Kryetarja jonë e ndruar do të ishte mirë të ishte këtu, që tja thoja në sy do kisha shumë dëshirë në fakt, del sa mirë i përgëzon ata fermerët, ata blegtorët, shkon shtëpi më shtëpi, nuk u qan hallet por shkon për të marr informacionet, dhe e di ku është e keqja? Që u shkakton dhe dëm, sepse bën ato fjalimet e bukura atje i hedh nëpër rrjetet sociale, atje ku ka dëshirën ose sikur e ka ajo pronën e saj. Mirëpo harron që i shkakton probleme ekonomike atij fermerit, atij blegtorit që shkon atje dhe ekspozon atë stallën e lopëve, që me zor dhe me djersë, me mund, me sakrificë e ka ngritur atë stallë, atë produkt që ai mban familjen. Ndërsa kur vijnë të tjerë persona, qytetarë që kërkojnë ndihmë këtu në bashki, dera është e myllur, të flet ai polici njëherë, do të hysh sdo të hysh, do debatohet 10 herë. Asnjë të drejtë skanë të shkretët të hipin shkallët. Konkluzioni është që

Kryetarja nuk i pret qytetarët lart në zyrën e saj, por e pi kafen atje ku i intereson, pa njoftuar pa informuar, në dëgjesa publike nuk vjen hiç, nuk vjen Kryetarja se lodhet. Singersht kam respekt për Maksin dhe më vjen keq që Maksi i merr të gjitha ato shuplaka nga gjithë banorët e zonës së Sukut atje, sepse të gjitha kërkesat dhe vërejtjet janë të pranueshme, ka një Kryetare bashkia, do ishte mirë të ishte atje. Është viti i dytë që bëhen dëgjesa publike dhe asnjëherë se kam parë Kryetaren, duhet të ishte atje dhe asnjëherë. Ndërkohë pardje shkon në një stallë lopësh, shkon nëpër serat, pse nuk shkon znj.Kryetare në sezon kur shiten këto prodhime në muajin Shtator kur kanalet mbushen plotë, në muajin Maj e Qershori kur fermerët qajnë me pikë të lotit, rrinë si fukarenj nëpër pikat e grumbullimit se të gjithë ata janë kryeneç, se vjen Taulant Balla për ti premtuar gjëra, pislliçe atje, i gënjen pikat e grumbullimit dhe fermerët qajnë me pikë të lotit atje në shtëpi se kanë familjet për të mbajtur. Ky është realiteti duhet ta pranoni. Maksi-sot që flasim bashkë janë blerë 50 koka fotovoltaikë për ndriçim, dhe një pjesë e tyre do të vendoset dhe në Suk 1 në Agaçaj. Në buxhetin e vitit 2025 kemi menduar që këta ndriçues të janë 3-4 fishi për vitin tjetër. Ne kemi investuar të paktën në Ngjeqar në disa pika që janë vendosur, dhe në pikat kryesore, atje ku thoni ju keni plotësisht të drejtë, qoftë edhe nëpër kthesa apo nëpër vendet e tjera do vendosim këto 50 tani brenda këtij viti. Dhurata-doja dhe një përgjigje nga Orgesa, a e di ti sa është numri i këtyre qytetarëve që paguajnë taksë ndicimi dhe gjelbërimi ndërkohë që se kemi, ka ndonjë shifër? se është për të ardhur keq, Dhurata më thonë mua ti se ngrë zërin atje, ne pse ta paguajmë këtë? Orgesa-shifër konkrete unë nuk kam këtu për momentin, mund ta sjellë unë një informacion shumë të detajuar, por di të them në të gjitha lagjet të cilat e përfitojnë këtë shërbim ne na vjen informacioni nga ndërmarrjet përkatëse, dhe ato lagje të cilat nuk e përfitojnë sipas informacionit që vjen prej tyre, ne i kemi hequr këto si tarifë. Dhurata-po si ke hequr se banorët e lagjes Agaçaj mua po më ankohen, ne skemi as gjelbërim as ndriçim pse duhet të paguajmë taksa thonë, nuk je e sigurt ,bëni një verifikim ju lutem se është gjynah. Orgesa-për numrin konkret të familjeve që paguajnë nuk jam shumë e sigurt që të them fiks sesa është, por mund ta nxjerr si informacion dhe të ta kalojë nesër. Ndërsa për ato lagje që nuk e kanë shërbimin e gjelbërimit dhe ndriçimit nuk i kam faturuar, sipas informacionit që vjen nga ndërmarrja përkatëse. Dhurata-unë e kam informacionin e plotë, madje ka ardhur qytetari që jetonte në Itali, aty keni vendosur një rregullore në të cilën qytetarëve që banojnë jashtë shtetit dhe kthehen për një kohë të shkurtër atje, duhet të plotësojnë ca rregulla, do të paguajnë një tarifë shërbimi aty në bashki. Orgesa-për ditët e qëndrimit, është në paketën fiskale. Dhurata-për ditët e qëndrimit thashë edhe unë, po ku do arrijë ai qytetar që vjen për 2 javë, të thashë minimumi duhet ti shohesh pak, duhet ti shihni me shumë qetësi se gjynah se po paguajnë taksa, se kanë ankesë se kot nuk e ngrita problemin. Fredi-është një tarifë për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit për karburantet, kjo është njëllojë për të gjithë? Orgesa-po. Fredi-dhe është një tarifë që më duket se ke mbivendosje, sepse ata njëkohësisht kanë marr lejen e mjedisit, plus është dhe një taksë tjetër, taksë apo tarifë 200 mijë lekë të reja që është vit për vit edhe ajo, plus edhe kjo. Orgesa-për licënsimin e karburantit, karburantet nuk e paguajnë tarifën e liçensimit. Fredi-ajo që e paguajnë 5 vjet rresht. Orgesa-po, për atë po flas, asnjë nga karburantet nuk e ka të paguar, pasi nuk marrin autorizim hyrje-daljet në rrugë, për sa kohë nuk e marrin këtë autorizim, nuk mundemi që ti liçensojmë. Fredi-ma kanë ngritur si shqetësim, është drejt falimentimit për shembull, është karburanti i zonës tonë, ai aq pune ka, sepse ata faktikisht e kanë lejen mjedisore, është mbivendosje. Orgesa-tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit është bërë një raport mjedor, i cili është bërë nga ekspertë të mjedisit jo nga punonjësit e bashkisë, dhe kanë dal në konkluzionin që të gjitha këto subjekte që ne i kemi përmendur këtu,

shkaktojnë ndotje shumë të madhe në mjeshtërisht, dhe kjo ndotje e madhe e mjeshtërisht prapa kësaj ndotjes vjen me një relacion me të cilin do punohet për të përmirësuar mjeshtërisht. Fredi-ndotje akustike? Orgesa-po. Fredi-ku ka ndotje akustike atje, më shumë bën një djalë me motorr sësai një karburant, një djalë që çon marmitën e motorrit është ndotje akustike më shumë sësai ai që është në mes, ska as familje. Unë nuk e kuptoj, është mbivendosje dhe nuk e di pse nuk e hedhin në gjyq ata. Orgesa-e kanë hedhur në gjyq dhe kjo është zbardhur nga gjykata. Fredi-herët e parë nuk e ka miratuar Prefekti se e ka parë të jashtëligjishme, nuk e ka miratuar Prefektura dhe ju si bashki keni hedhur në gjyq Prefekturën. Në gjyq mbështetje keni fituar por problemi është që edhe llogjike është e jashtëligjshme, sepse nuk shkakton ndotje karburanti atje që ska as familje, dhe është drejt falimentimit se ma ka shprehur 100 herë dhe është ashtu, u interesova dhe më thanë që nuk e hodhëm ne në gjyq por e ka hedhur Prefektura. Zyra juridike në Prefekturë nuk e ka miratuar dhe bashkia ka hedhur zyrën juridike të Prefektit, më duket se është mbivendosje, ta shikojmë që mund ta heqim sepse është drejt falimentimit. Orgesa-gjyqin nuk e ka hapur bashkia. Maksi-e ka hapur Prefektura gjyqin dhe është fituar nga ana e bashkisë. Fredi- e dyta, qytetarët paguajnë tarifë për ndriçimin në rrugë, unë jam koshient sepse është bërë gjë e mirë, por janë djegur llambat. Unë kam marr dhe numrin e atij dhe më vjen zor ta marr, është fakt të shikosh gjysmat e llambave, ço një hiq një dhe ato e djegin njëra-tjetërën sepse në qoftë se nuk ndodhen të gjitha llambat bashkë ato djegin, ka më shumë fuqi njëra them une sepse nuk jam elektricist. E dyta tarifë është e pastrimit të mbeturinave, ata kazanët e mbeturinave me çà i dizifiktoni? Unë e dua nga z.Maksi, çà dizifikanti përdorni? Maksi- klor. Fredi-nuk është klor z.Maksi unë e kam evidentuar, nuk është klor kam marr 2 herë në muaj të ndryshëm dhe nuk është klor. Maksi- gëlqere nuk është. Fredi- më fal e the vet, është gëlqere. Maksi-po nuk është thashë. Fredi-po jo e the vet ti se unë se thashë, se unë sjam specialist, unë nuk e kam çuar për analiza, e kam marr 2 herë. Maksi-unë të thashë të paktën gëlqere nuk është, po përqindjen e klorit..Fredi-nuk ka erë klori fare, nuk e kam çuar për analiza mos të gënjej, do ta çoj për analiza, e kam marr me filmim. Maksi-mos abuzo me fjalët e mia, unë thashë të paktën gëlqere nuk është, është klor por se di sesa % ka klor. Fredi-unë kam marr sepse e kam vërtetuar 1 herë, epo thashë hajt gabimisht se punëtor janë, në muaj të ndryshëm dhe nuk është klor. Unë nuk jam specialist por ka ndryshim shumë, sepse kile klorit mund të jetë 5 mijë lekë dhe kile gëlqeres mund të jetë 100 lekë, 70 lekë. Nuk dua të them me abuzim se mbështetje së pasur, por kam marr në muaj të ndryshëm, kam një qeskë që e kam marr me filmim kur kanë hedhur punonjësit, e kam marr kjo është dhe po të duash vërtetoje që nesër në mëngjes. Kur ai qytetari paguan për klor nga taksat dhe atje hidhet nuk e di se çà, se sjam i saktë nuk kam bërë analizë por e kam këtu pluhur, vetëm klor nuk është. Unë jam dhe i mendimit që qytetarët që kanë minus 30% të taksës së tokës, janë ca të prapambetura, keni një shifër sa keni taksë të prapambetura dhe sa keni mbledhur vitin e fundit? Orgesa-unë informacionin e kisha në çdo dëgjesë sa është debia për secilin fshat, duke qënë se nuk e kërkoi asnjëri nga ju, unë nuk e kam tanë me vete, por që i kemi se janë tek raporti i KLSH-së të gjitha informacionet. Fredi-të mirëkuptojë, unë ta bëra pyetjen sepse kam një propozim që të hiqen edhe këta deri në 30%, që të ndikojë në mbledhjen e taksës nga qytetarët që janë të prapambetura, deri në Dhjetor. Maksi-duhet parë baza ligjore. Fredi-ore të bëjmë një provë, ai është shtet dhe fal taksën, ne po e miratuam sot çà do parë baza ligjore, është ligjore sepse e kemi bërë. Ne e miratojmë, nëse nuk është ligjore ta kthen Prefektura. Maksi-do parë efekti financiar. Kryetari- në qoftë se ne miratojmë diçka të tillë, asnjë qytetar nuk do preferojë që të paguaj sepse do presi. Fredi-absolutisht nuk ti fal njeri, atë bëjnë dhe sigurimet shoqërore, rrinë kaq vjet e shikojnë që skema nuk shkon bëjnë një falje, ndryshojnë diçka

që të mblidhen. E kemi bërë ua them me sinqueritet, mos e merrni me kaq kundërshtim. Kryetari-unë jam shumë dakort me propozimin tënd, por do mendoja se do ishte me vend të parashikohej diçka e tillë nga mesi i vitit që vjen. Fredi-ore edhe muajin e fundit unë jam dakort, po prapë këtu jemi, ato asnjëherë nuk falen, ato janë si lekët e dritave që nuk falen. Maksi- po çà kërkon pastaj kur nuk falen, çà do të pezullohen? Fredi-jo, të bëhen nga Janari deri në 30 Qershori dhe të prapambeturat minus 30%, absolutisht të gjithë njerzit janë dakort, të mundohemi të mbledhim diçka. Leksi- kjo që propozon Fredi është gjë e mirë por kam hall se bie ndesh dhe me pjesën tjetër që paguan 100%. Fredi-po ne se bëjmë vit për vit, ta bëjmë një herë. Kryetari-propozimi duhet marr në shqyrtim, në konsideratë patjetër. Ne smund të marrim një vendim sot për atë, pa sqaruar saktësisht bazën ligjore. Në parim unë do isha shumë dakort me një propozim të tillë, ajo do zbatohet gjatë vitit, ne kemi të drejtën në qoftë se baza ligjore na lejon. Fredi-po kaloi paketa fiskale pastaj çà do bësh ti ? Maksi-ndryshon ajo. Fredi-jo si ndryshon ajo, nuk ndryshon fare, ne e miratojmë, në qoftë se ska bazë ligjore..Maksi-nuk flitet në vendimin e Këshillit në qoftë se. Fredi- ne e kemi miratuar dhe është quajtur e ligjshme. Kryetari-propozimi duhej të vinte që në Komisionin e Ekonomisë. Unë e gjej me vend si nismë, nuk e gjej të zbatueshëm tanë, ky duhej të vinte që në Komisionin e Ekonomisë që këtu të vinte si i plotë dhe jo i diskutueshëm. Ne nuk mund të ikim sot po na e quajtën dhe po sna e quajtën. Megjithatë unë e ftoj administratën ta marri në konsideratë, ta shqyrtoj dhe po e shpreh që sot gadishmérinë time për ta mbështetur. Fredi- si çezmat e Ngjeqarit, çà konsiderate, ta propozojmë sot. Orgesa-për vitin 2025 deri në Qershori paguhen 70%, është përfshirë në paketen fiskale. Fredi-ajo është e përfshirë në paketë, dhe mund të përfshihet edhe kjo, nuk është asnjë gjë. Kryetari-po nuk është problemi se po na thotë ti dhe do ta besojmë, kjo kërkon të marri vëmendjen e vet ligjore. Fredi-ore në qoftë se nuk është ligjore as unë skam çà them, e miratojmë kështu siç jemi dhe ju jeni dakort, na bëni pjesë të paketës fiskale kështu siç është dhe me ato, dhe jemi prapë dakort. Kryetari pyet Orgesën se a mund të ndyshojë? Orgesa-duhet bërë një analizë shumë e thellë. Maksi-duhet të kalojë në Komisionin e Ekonomisë, të vij propozimi në Këshill, nuk vjen nga një individ. Fredi-unë nuk jam individ. Kryetari-një këshilltar nuk mund të vij të bëj propozim. Fredi-por po të jemi shumë nuk ka nevojë për propozimin tim, hidhet në votë dhe mbaroi filmi. Kryetari- ishte një për formën e propozimit, nuk është një se ti je shumëkushi, nuk thamë që sje. Problem është se në formën e propozimit ishte një këshilltar. Fredi-ky propozim është dhe llogjik dhe ligjor, ju garantoj unë për këtë. Në qoftë se ju doni ta miratoni, miratojeni por na bëni pjesë të votimit edhe për paketen edhe për ndryshimet, por ama ato janë shqetësimi, unë prandaj kërkova informacion nga zonja. Ajo është ligjore sepse e kanë bërë. Elmazi- për paketen fiskale unë jo vetëm që jam dakort me parafolësit, kur është diskutuar vite më para përsa u përket qytetarëve të cilët nuk përfitojnë as gjelbërim dhe as ndriçim, dhe në këtë paketë që ju paraqisni këtu është kontrolluar e gjithë zona nga Ngjeqari deri në Arapaj, dhe nga Arapaj deri në Jagodinë, cilat zona nuk marrin ndriçim brënda fshatit dhe a u është hequr këtyre apo jo? E dyta, e nderuar punonjëse fermerët kanë tokat bujqësore dhe paguajnë detyrimet ndaj bashkisë me aq sa është vënë vlera, kaluam njëherë në Këshill 500 lekë të vjetra për m/linear për të pastruar kanalet e treta, dhe unë mesa di qofsha i gabuar dhe kërkojë ndjesë, nuk është vënë dorë në asnjë vend. A është kjo në plan për tu bërë apo nuk është? Sepse do vij një ditë, mos o zot siç ra andej jashtë shiu, ato do myten do bëhen si këneta që ka qënë dikur. E dyta, ngritën kolegët një problem dhe unë jam dakort, por aparati juaj duhet ta rishikojë dhe ai duhet të na bjeri materjalin këtu në Këshill që ne ta kalojmë, ndryshtë nuk bëhet, pse them unë apo mendoj unë, unë mund të mendoj shumë gjëra. Maksi-sa i përket kanaleve të treta jemi të vëtdijshëm që ka


problematika të theksuara në kanalet e treta, jo të gjithë fermerët e kanaleve të treta e paguajnë atë taksë për të pastruar, nga 10 paguajnë 5 apo 2, po nuk paguan të 10 nuk mund të bëhet pastrimi. Pra ka problematika të theksuara që ju e dini më mirë se ne, kemi dështuar me kanalet e treta, por gjithmonë dhe me ligj nuk ka qënë asnjëherë detyrë për ta bërë, dëshira jonë është për ta bërë por mundësia nuk është. Dhurata- Maksi u tregua i sinqertë kur tha që kemi dështuar, por a mund të bëhet ndonjë gjë, se vërtet situata është serioze. Ne tani jemi në stinën e dimrit, e kam këtë problematikën edhe tek prona ime se unë tani kam bërë 600 m² serë dhe është për të ardhur keq. Ju thoni merret taksë për kanalin por kanali nuk është bërë, më fal nuk dua të flas vetëm për veten time por kjo është problematikë e të gjithë fermerëve aty për kanalet e treta, të dytat fare se të tretat është larg por të dytat, nuk ka një rrugëzgjidhje? Maksi-për të dytat kemi bërë, jo skemi bërë në mënyrë kategorike, se kemi punuar me dy ekskavatorët që kemi pasur, i kemi pasur në punë në të katërtat njësitë. Dhurata- ti i thua një problem madhor atij drejtoret të ujërave Agron Dardha, dhe tha që në asnjë mënyrë u përgjigj shumë arrogant, kjo nuk është sjellje e duhur, jo se kemi përgjegjësi, se kemi për detyrë, bëni si të doni. Maksi- ai në qoftë se është përgjigjur ashtu të kërkoj ndjesë unë në emër të administratës, por në kanalet e dyta dhe kanalet e para është punuar, dhe është punuar goxha mirë tërë kohës, të dy skrepat që kemi ne i kemi në punë. Dhurata- shiko ti mirë e ke se dhe Kryetarja vajti vet atje, e bëri Tapi gazsjellësi pjesën e kanalit, vajti hodhi video Kryetarja sikur e bëri ajo, tani çà do të thotë kjo? E ti thua kemi bërë shumë, po skeni bërë shumë se faktet flasin, unë nga kanalet jam, anës lumi banoj, atje kam banesën, atje kam pronën. Maksi-pjesën më të madhe të kohës dhe unë andej e kaloj. Dhurata-shikojeni pak me seriozitet se tani erdhi dhe dimri, përmbytemi. Nuk ka më diskutime. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 11 vota pro, 3 vota kundër Dh.Malka,E.Xhaxhaj,F.Feleqi. Miratohet.

8.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Nuk ka diskutime. Kryetari-të nderuar këshilltar, meqënëse kjo është mbledhja e muajit Nëntor dhe ne jemi në prag festash, me lejoni që tju uroj gjëzuar 28-29 Nëntorin, 80-Vjetorin e Çlirimit. Nëpërmjet jush uroj dhe gjithë qytetarët e bashkisë tonë, gjithë shqipëtarët kudo që janë nëpër botë. Gëzuar festat dhe faleminderit. E deklarojë të mbyllur mbledhjen e datës 25.11.2024.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

